



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality of Prishtina



01-168

Datë / a:	24.05.2019
Referencë:	05-350/02-25264/19 dt. 05.02.2019
Për / Za/ To:	Arif dhe Basri Gashi , lagjja "Muhaxhirët" Prishtinë
Nga /Od/ From:	Krenare Shkodra, zyrtare - Drejtoria e Urbanizmit
Përmes/Preko/Through:	Mimoza Berisha Prestreshi, u.d. udhëheqëse e sektorit - Drejtoria e Urbanizmit
CC:	Ardian Olluri, Drejtor Drejtoria e Urbanizmit
Tema /Subjekat/Subject:	Plotësim Dokumentacioni

Arif dhe Basri Gashi, nga Prishtina, me kërkesën 05 nr.350/02-25264/19 dt. 05.02.2019, i janë drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e ndërtesës shumë-banesore me afarizëm, në kuadër të parcelës kadastrale nr.2595-1 ZK Prishtinë.

Drejtoria e Urbanizmit, gjatë shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të bashkangjitur në të, konstatoi se parcela kadastrale në fjalë, ndodhet në kuadër të Planit Rregullues "Muhaxhirët", i miratuar me Vendimin e Komunës së Prishtinës 01 nr. 35-1299 dt. 29.06.2010, dhe sipas këtij Plani, kjo zonë është e paraparë për ndërtimin të lartë miks. Sipas propozimit të prezantuar, ndërtesa për të cilën është kërkuar caktimi i kushteve ndërtimore, shtrihet pjesërisht edhe në parcelën kadastrale nr.10143 ZK Prishtinë, hapësirë kjo e cila është rezervuar sipas Vendimit 05 nr.350-77220 dt.20.05.2016 për caktimin e kushteve ndërtimore për parcelën kadastrale nr.2595-3 dhe 2595-2 (tani parcela nr.10143) ZK Prishtinë. Njëherit, projekt propozimi i prezantuar, përkatësisht vendosja e ndërtesës në kuadër të parcelës, nuk është në përputhje me situacionin e miratuar në Vendimin e lartcekur, ku distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelës kadastrale nr.2593-1 ZK Prishtinë, aktualisht rruga "Edmond Hoxha" (sipas prezantimit të aplikuesit), nuk është në përputhje me atë të përcaktuar sipas Planit Rregullues "Muhaxhirët".

Duke qenë se Vendimi i lartcekur për kushte ndërtimore, ku i është rezervuar hapësira ndërtesës në fjalë, është lëshuar bazuar në pëlqimin e noterizuar Ref.LRP.Nr.8333/16 dt.26.04.2016, sipas të cilit, 'Sejdi Gashi, Basri Gashi, Arif Gashi, Hamdi Makolli, Enver Gashi dhe Ibadete Morina, kanë dhënë pëlqimin që të ndërtohet ndërtesa në kuadër të parcelave nr.2595-2 dhe 2595-3 (tani parcela nr.10143-1), që kësaj ndërtesë do ti bashkangjitet ndërtesa që do të ndërtohet në parcelat nr.2595-1 dhe 2595-8, dhe pjesa që kalon në parcelat tjera (tani parcela nr.10143-1) është vetëm 36m², u konstatua se zgjidhja e prezantuar në kërkesën në trajtim, është në kundërshtim me pëlqimet e dhëna të pronarëve dhe bashkëpronarëve fqinj, andaj komisioni i zyrtarëve, i caktuar për mendim profesional për lëndën në fjalë, ka vendosur që me qëllim të vazhdimi të shqyrtimi të kërkesës në fjalë,

dhe vendosjes në të drejtë të çështjes, e njëjta duhet të plotësohet me dokumentacionin si në vijim:

- Përmirësimin e projektit konceptual: harmonizimi i propozimit me kriteret e Planit Rregullues "Muhaxhirët", përkatësisht respektimi i distancës nga parcela në pjesën Jug-Perëndimore, ku distanca nga kufiri i parcelave fqinje duhet të jetë 0.3H, përkatësisht të respektohet pjesa grafike e Vendimit 05 nr.350-77220 dt.20.05.2016, ku edhe është pozicionuar ndërtesa nr.2, apo të mbete distanca 7m' (pa hapje), me kusht që të arrihet marrëveshja e re me pronarët e parcelave kadastrale nr.10143-1 dhe 2595-8 ZK Prishtinë;
- Të prezantohet manuali gjeodezik, në Sistemin Koordinativ KosovaRef01, për bashkimin e parcelave kadastrale nr.2595-1, 10143-1 dhe pjesërisht parcelës nr.2595-8, (duke qenë se ndërtesa është propozuar të ndërtohet mbi kufirin e parcelave nr.2595-1 dhe 10143-1), apo të bëhet korrigjimi i kufijve në mes të parcelave kadastrale nr.10143-1 dhe 2595-1 ZK Prishtinë;

Plotësimi i dokumentacionit duhet të bëhet, konform nenit 21 pika 4 e Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110, dt. 31/05/2012, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të kësaj informate.

I dorëzohet: Kërkuesit, në dosje të lëndës, kësaj drejtorie, dhe Qendrës për Shërbim me Qytetarë.